



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 55 regjistër (JR)  
Datë 04.10.2021

Nr. 24 i vendimit  
Datë 04.07.2022

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Relatore</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 04.07.2022, në orën 09:30, ditën e hënë, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 55/2021, datë 04.10.2021, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Darjel Sina.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 392, datë 28.05.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi).

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisioneren Publike Irena Nino, e cila përfundimisht kërkoi<sup>1</sup> ndryshimin e vendimit nr. 392, datë 28.05.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), që kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

### I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi) (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurores në prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Fillimisht, në funksion dhe për zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht: deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), sipas të cilave ka rezultuar:

**2.1** ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport<sup>2</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

1. *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin.*
2. *Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë.*
3. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
4. *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
5. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**2.2** DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka

<sup>1</sup> Në vendimin e përmbledhur të Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), është shënuar se Komisionerja Publike Irena Nino kërkoi lënien në fuqi të vendimit, në fakt kërkoi ndryshimin e tij.

<sup>2</sup> Raporti i ILDKPKI-së nr. {\*\*\*} prot., datë 12.11.2019.

kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, DSIK-ja ka përcjellë në Komision raportin për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, me konstatimin për përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës. Në vijim, nga Komisioni është kërkuar<sup>3</sup> përditësimi i raportit për kontrollin e figurës dhe për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 03.02.2021, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.02.2021, të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

**2.3** KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar raportin e hollësishëm e të arsyetuar me nr. {\*\*\*} prot., datë 26.12.2019, për subjektin e rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi).

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e rivlerësimit (të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale), mori vendimin objekt shqyrtimi nr. 392, datë 28.05.2021.

## **II. Në lidhje me vendimin e Komisionit**

4. Komisioni, me vendimin nr. 392, datë 28.05.2021, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), me detyrë prokurore pranë prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.
5. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.

**5.1. Për vlerësimin e pasurisë:** “Në përfundim të shqyrtimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues i Komisionit çmon se, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit dhe duke vënë në balancë vlerën e kësaj pamjaftueshmërie nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, në shumën 1.648.646 lekë, për krijimin jo vetëm të pasurive të deklaruara në DPV-në e vitit 2013 (përpara martesës ligjore), por edhe të blerjes së pasurive të tjera dhe kryerjes së shpenzimeve përpara vitit 2013, të shtrira të gjitha këto në një periudhë 13-vjeçare (2001 – 2013), faktet dhe provat rrethore të krijojnë bindjen se kjo mungesë nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe të përbëjnë për pasojë një shkak për vendosjen

---

<sup>3</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 08.04.2020.

e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për këtë arsye, Komisioni konkludon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë”.

**5.2. Për kontrollin e figurës:** “Subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, dhe ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016”.

**5.3. Për vlerësimin e aftësive profesionale:** “Komisioni, në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), është “e aftë” pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është efiçiente në masë të pranueshme”.

### **III. Në lidhje me shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik**

6. Bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “c” e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 22 e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 08.09.2021, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë: “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 392, datë 28.05.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi). Në mënyrë të përmbledhur, ONM-ja vlerëson se vendimi i Komisionit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), ka mangësi serioze logjike në pjesën arsyetuese, rezultat i një procesi rivlerësimi të papërshtatshëm dhe jo të saktë. Komisioni, i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, çmon se një vlerësim i drejtë i kriterit të pasurisë në tërësinë e tij, do të çonte në shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, pasi ai ka dështuar për të arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, referuar nenit 59, pika 1, shkronja “a”, lidhur me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**6.1** Sipas përmbajtjes së rekomandimit, është i nevojshëm të kryhet hetim dhe vlerësim i plotë sipas standardeve ligjore dhe financiare të vendosura nga Kolegji mbi çështjet e ngritura në rekomandim. Si përfundim, ONM-ja, bazuar në pikën 2 të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, i ka rekomanduar Komisionerit Publik të ushtrojë ankim mbi vendimin nr. 392, datë 28.05.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi).

7. Komisioneri Publik Darjel Sina (në vijim “Komisioneri Publik”), bazuar në rekomandimin e ONM-së, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 392, datë 28.05.2021, për subjektin e rivlerësimit, duke kërkuar kontrollin e këtij vendimi nga Kolegji. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, të cilat lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

7.1 Lidhur me pasurinë e referuar si **“likuiditetet në cash”**, Komisioneri Publik mban në vëmendje praktikën e konsoliduar të Kolegjit<sup>4</sup>, i cili ka vlerësuar se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklarimet periodike të interesave, është mbizotërues, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë e cila ka parashikuar në mënyrë të posaçme vlerën provuese të deklaratave periodike të interesave. Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, ndan qëndrim të ndryshëm nga përfundimi i arritur nga Komisioni, lidhur me saktësinë e deklarimit për likuiditetet *cash*, duke pamundësuar verifikimin e burimeve të ligjshme të pasurive të rrjedhura prej tyre.

7.2 Në lidhje me **mjaftueshmërinë** dhe burimin e ligjshëm të krijimit të likuiditeteve *cash* në shumën 4.000.000 lekë, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk rezultojnë ta kenë përdorur shumën *cash*, prej 4.000.000 lekësh, për të investuar në pasuri të tjera, përveçse për blerjen e automjetit me targë {\*\*\*}, ndërsa Komisioneri Publik vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë likuiditete *cash*, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b”, në lidhje me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

7.3 Lidhur me pasurinë **automjet, tip “Mercedes Benz”, me targa {\*\*\*}**, Komisioneri Publik vlerësoi se, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur detyrimin ligjor për të deklaruar pasuritë në pronësi dhe burimin e krijimit të tyre, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e automjetit, si rrjedhojë ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b”, në lidhje me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

7.4 Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, Aneksit të Kushtetutës, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë

7.5 Mbështetur në parashikimin e nenit F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik kërkoi që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, pas vlerësimit tërësor të procedurave, për subjektin e rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), në përfundim të gjyqimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 392, datë 28.5.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi).

---

<sup>4</sup> Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 11/2019 (JR); 19/2019 (JR); 20/2019 (JR); 27/2020 (JR).

8. Në dokumentacionin e administruar në dosjen e Komisionit, gjendet e administruar një memorie në lidhje me rekomandimin e paraqitur nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, e dërguar nëpërmjet postës elektronike nga subjekti i rivlerësimit, më datë 22.09.2021, drejtuar Komisionit, Komisionerit Publik dhe ONM-së. Në këtë memorie, subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), sjell argumentin e saj në lidhje me rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, tek i cili shprehet: *Përtej argumenteve të paraqitura nga ana ime, gjatë hetimit administrativ në KPK, se bashkëshorti mbulon me burime të ligjshme krijimin e kësaj pasurie dhe pavarësisht faktit nëse shuma prej 1.648.646 lekësh, është përdorur për krijimin e ndonjë pasurie apo jo, vlerësoj se vendimi i KPK-së i marrë ndaj meje, është në përputhje me shumë vendimmarrje të KPK-së (të cilat ONM-ja dhe Komisioneri Publik nuk i kanë ankimuar), ashtu dhe vendimmarrjen e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Duhet theksuar se praktika e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por edhe ajo e KPK-së, ka vendosur një standard të ndryshëm për diferencat negative, kur këto diferenca konstatohen për pasuritë e personave të lidhur përpara martesës në krahasim me ato të konstatuara për pasuritë e subjektit apo personit të lidhur gjatë martesës. Në këtë drejtim, praktika e të gjitha institucioneve të vetting-ut është e unifikuar (përfshirë edhe Komisionerin Publik, si dhe ONM-në). Edhe vendimi nr. 392, datë 28.05.2021, është në sinkron me këtë praktikë.*

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### *A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit*

###### *i. Juridiksioni i Kolegjit*

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### *ii. Legjitimimi i ankuesit*

10. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

11. Në përputhje me nenin 65<sup>5</sup>, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë gjyqësore publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 392, datë 28.05.2021, për subjektin e rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të Komisionerit Publik dhe subjektit të rivlerësimit.

*B. Mbi aspektet procedurale lidhur me provat dhe kërkesat e Komisionerit Publik, si dhe me parashtrimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor, Kolegji konstaton si më poshtë.*

12. Në seancën gjyqësore publike të datës 20.06.2022, Komisioneri Publik, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, parashtrroi se, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur detyrimin ligjor për të deklaruar pasuritë në pronësi dhe burimin e krijimit të tyre. Komisioneri Publik parashtrroi gjithashtu se nga analizimi i deklaratës periodike për vitin 2014, nuk rezulton të jetë deklaruar burimi i krijimit të likuiditeteve *cash* apo pakësimi i tyre, për rrjedhojë, sikurse dhe Komisioni ka konstatuar, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme financiare në momentin e blerjes së kësaj pasurie, në shumën prej -1.386.783 lekësh. Në kuadrin e kontrollit të kriterit të pasurisë dhe vlerësimit tërësor të çështjes, pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme në krijimin e kësaj pasurie, do të rezultonte edhe nëse marrim në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit: “[...] se mosndryshimi i gjendjes *cash* nuk do të thotë se gjatë vitit, kjo gjendje nuk ka ndryshuar [...]”, në fund të vitit 2014, për një diferencë negative në vlerën - 352.255 lekë. Komisioneri Publik vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b”, në lidhje me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
13. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e paraqitura në Kolegj në seancën e datës 20.06.2022, në përfundim, kërkoi që qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, është i mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve që kanë rezultuar nga hetimi dhe në legjislacionin e zbatueshëm. Në këto kushte, vendimi i Komisionit nr. 392, datë 28.05.2021, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe, për këtë arsye, kërkohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit lënien në fuqi të këtij vendimi.

---

<sup>5</sup> *Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.*

14. Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e ngritura në ankim nga Komisioneri Publik, duke i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të mbrohet dhe të japë shpjegime në lidhje me to. Kolegji vlerësoi të gjitha shkaqet e ankimit në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, të përbërë nga aktet e përcjella në Kolegji nga Komisioni dhe parashtrimet e depozituara nga palët gjatë seancave publike. Bazuar në situatën faktike të konstatuar dhe legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionet e mëposhtme.

*C. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit*

15. Lidhur me pasurinë e referuar si **“likuiditetet në cash”**, Komisioneri Publik mban në vëmendje praktikën e konsoliduar të Kolegjit<sup>6</sup>, ndaj ka vlerësuar se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratimet periodike të interesave, është mbizotërues, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë e cila ka parashikuar në mënyrë të posaçme vlerën provuese të deklaratave periodike të interesave. Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, datë 08.09.2021, ndan qëndrim të ndryshëm nga përfundimi i arritur nga Komisioni, lidhur me saktësinë e deklaratimit për likuiditetet *cash*. Për këto likuiditete *cash* të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik pretendon se ka mospërputhje, pasi, bazuar në deklaratat periodike vjetore, gjendja e tyre në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, duhet të jetë 1.400.000 lekë, ndërkohë që në këtë deklaratë, nuk janë deklaruar kursime *cash*. Komisioneri Publik pretendon se ka deklarime kontradiktore në procesverbalet e ILDKPKI-së, të mbajtura brenda një harku të shkurtër kohor, lidhur me gjendjen e *cash*-it. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, më datë 29.01.2016, deklarohet se gjendja *cash* prej 4.000.000 lekësh është ende në banesë, ndërsa në procesverbalin e datës 23.02.2016, deklarohet se në atë moment, gjendja *cash* në banesë ishte në shumën 1.300.000 lekë, e cila është depozituar në bankë. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe kontradiktor lidhur me likuiditetet *cash*, duke pamundësuar verifikimin e burimeve të ligjshme të pasurive të rrjedhura prej tyre.

15.1 Komisioni, në vendim, për gjendjen *cash* prej 4.000.000 lekësh, ka arsyetuar si vijon: Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se pretendimi i subjektit nuk mund të merret në konsideratë në analizën financiare, për sa kohë që ky pakësim nuk është deklaruar në deklaratën periodike vjetore përkatëse, por çmon të theksojë se subjekti e ka deklaruar vullnetarisht këtë pasaktësi në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-

<sup>6</sup> Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 11/2019 (JR); 19/2019 (JR); 20/2019 (JR); 27/2020(JR).



*së në datën 23.02.2016, në përgjigje të pyetjes nr. 12 – nëse ka për të deklaruar pasuri, detyrime, biznes apo interesa të padeklaruar më parë në deklaratat periodike vjetore dhe se kjo ndreqje bën që gjendja e likuiditeteve cash në deklaratën vetting të jetë zero, çka përputhet me deklarin e subjektit në këtë deklaratë”.*

**15.2** Deklarimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur ndër vite, për likuiditetet *cash*, janë si më poshtë vijon.

i. Në deklaratën e interesave privatë të para fillimit të detyrës, të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Lekë gjendje në shtëpi, shuma 600.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”.

ii. Në deklaratën e interesave privatë periodikë (në vijim “DIPP”) të vitit 2013, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, si person i lidhur ka deklaruar: “Gjendje të ardhurash *cash*, krijuar nga puna në vite, prej vitit 1998. Vlera: 4.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”.

iii. Në DIPP-në e vitit 2015, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit si person i lidhur, ka deklaruar: “Pakësim i gjendjes së të ardhurave *cash* (blerje automjeti dhe shpenzime të ndryshme familjare). Vlera: 1.900.000 lekë”.

iv. Në DIPP-në e vitit 2016, personi i lidhur ka deklaruar: “Pakësim i kursimeve. Vlera: 1.300.000 lekë”.

v. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), dhe bashkëshorti i saj, si person i lidhur, nuk kanë deklaruar gjendje të kursimeve *cash*.

**15.3** Kolegji vëren se, bazuar në deklaratat periodike vjetore të cituara në paragrafin më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e interesave privatë, para fillimit të detyrës në vitin 2007, ka deklaruar kursime *cash* në shumën 600.000 lekë. Në momentin e këtij deklarimi, subjekti i rivlerësimit ka qenë me status gjendjeje civile “e pamartuar”. Në vijim, në deklarin periodik të pasurisë për vitin 2013, përveç subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar për herë të parë edhe z. A. P., në cilësinë e personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit) që mbart detyrimin për deklarim të pasurisë sipas neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049/2003, i cili në deklarin e tij të parë, në DIPP-në e vitit 2013, ka deklaruar kursime *cash* në shumën 4.000.000 lekë. Si subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe personi i lidhur me të nuk rezultojnë të kenë deklaruar pakësim të kursimeve *cash* në deklaratat periodike vjetore për periudhën 2008-2014. Në DIPP-të e viteve 2015 dhe 2016, deklarohet pakësimi i likuiditeteve *cash*, në total në shumën 3.200.000 lekë (në 2015 pakësuar me 1.900.000 lekë dhe në 2016 pakësuar me 1.300.000 lekë). Sipas këtyre deklarimeve, gjendja e likuiditeteve *cash*, në datën 31.12.2016, llogaritet në vlerën 1.400.000 lekë, pra 800.000 lekë si tepriçë e *cash*-it të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe 600.000 lekë të subjektit të rivlerësimit, të cilat i ka deklaruar në deklaratën e para fillimit të detyrës (2007) dhe nuk ka deklaruar në vijim pakësim të tyre. Ndërkohë, në deklaratën *vetting*, nuk është deklaruar kursim *cash*. Gjithashtu, në deklaratat periodike pasardhëse të viteve 2017 dhe 2018, nuk janë deklaruar shtesa apo pakësime të likuiditeteve *cash*.

**15.4** Nga sa rezulton më sipër, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me shumën 800.000 lekë që, sipas deklarimeve periodike të personit të lidhur, rezulton të ketë mbetur gjendje në datën 31.12.2016 dhe nuk është deklaruar. Në

përgjigje, subjekti deklaroi se shuma prej 800.000 lekësh është shpenzuar në vitin 2014, por është harruar të deklarohet si shpenzim nga bashkëshorti për atë vit. Ky fakt është sqaruar në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së në vitin 2016. Në këtë pyetësor, subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), është pyetur edhe lidhur me gjendjen *cash* prej 600.000 lekësh të deklaruar nga ajo në deklaratën e para fillimit të detyrës në vitin 2007, për të cilat subjekti është përgjigjur se këto kursime janë shpenzuar në vitin 2013, por janë harruar të deklarohen si shpenzim në deklarin periodik që i përket atij viti.

**15.5** Kolegji konstaton se në dosjen e Komisionit, gjendet i administruar procesverbali i mbajtur pranë ILDKPKI-së, datë 29.01.2016, në të cilin subjekti i rivlerësimit është pyetur lidhur me gjendjen *cash* të realizuar nga puna e bashkëshortit, në shumën 4.000.000 lekë, në përgjigje të së cilës subjekti është përgjigjur se kjo shumë vazhdon të jetë gjendje në banesë. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se do ta depozitonte në bankë dhe për ta vërtetuar, do të paraqiste dokumentin bankar. Sipas këtij procesverbali, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se kjo shumë është akumuluar me të ardhurat e bashkëshortit, nga veprimtaria private shitje me pakicë, e ushtruar me prindërit e tij dhe, më pas, nga vetë bashkëshorti, si dhe punë të ndryshme private.

**15.6** Kolegji vëren se më datë 23.02.2016, ILDKPKI-ja ka mbajtur një procesverbal, nëpërmjet të cilit subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), ka sqaruar se gjendja *cash*, në vlerën 4.000.000 lekë, e deklaruar prej bashkëshortit të saj, është pakësuar ndër vite. Sipas sqarimit të saj në procesverbal, deri në datën 31.12.2014, gjendja ka qenë 3.200.000 lekë, ndërsa gjatë vitit 2015, është pakësuar sërish gjendja *cash*, pakësim të cilin ka shpjeguar se do e deklaronte në vitin e ardhshëm (në deklaratën periodike të vitit 2016). Subjekti ka sqaruar gjithashtu se në momentin e deklarin në procesverbal, gjendja *cash* është depozituar në bankë, në shumën 1.300.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në ILDKPKI dokumentin nga ABI Bank, datë 22.02.2016, i cili vërteton depozitim të kësaj shume sipas sqarimeve të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, në këtë procesverbal, pyetjes së ILDKPKI-së, nëse ka për të deklaruar pasuri, detyrime, biznes apo interesa të padeklaruar më parë, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur se në vitin 2013, ka harruar të deklarojë shpenzimet në shumën 600.000 lekë nga kursimet e saj dhe për vitin 2014, shpenzimet në shumën 800.000 lekë nga gjendja *cash* e bashkëshortit.

**15.7** Kolegji vëren se Komisioni, për përlllogaritjen e likuiditeteve *cash*, u bazua vetëm në deklaratat periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit, duke qenë se deklarinimet e saj në procesverbalet e ILDKPKI-së janë kontradiktore, duke konkluduar nga hetimi administrativ kryesisht, se ka mospërputhje në deklarinimet e subjektit pranë ILDKPKI-së, lidhur me deklarinimet e gjendjeve *cash*, pasi në procesverbalin e mbajtur më datë 29.01.2016, subjekti fillimisht deklaroi se gjendja *cash* prej 4.000.000 lekësh (akumuluar me të ardhurat e bashkëshortit) është ende në banesë, ndërkohë që në procesverbalin e mbajtur më datë 23.02.2016, subjekti deklaroi se shuma prej 4.000.000 lekësh, është pakësuar ndër vite, dhe deri më datë 31.12.2014 gjendja *cash* ka qenë 3.200.000 lekë. Gjatë vitit 2015, është pakësuar sërish, dhe aktualisht gjendja *cash* është në shumën 1.300.000 lekë. Lidhur me këto mospërputhje të rezultuara, Komisioni ftoi subjektin e rivlerësimit të paraqesë shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**15.8** Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, lidhur me arsyet për të cilat i kaloi barra e provës, ka sqaruar se: *Deklaroj se në momentin që ne kemi përpiluar deklaratën vetting, nuk kemi pasur gjendje cash. Deklarimi i saktë pranë ILDKPKI-së është ai i bërë më datë 23.02.2016, pasi jam konsultuar edhe me bashkëshortin. Gjendja e cash-it ka qenë pasuri personale e bashkëshortit e cila është administruar prej tij, prandaj nuk kam qenë shumë e saktë në deklarin e datës 29.01.2016. Pasi u konsultova me të, ai më shpjegoi se në fund të vitit 2014, nuk kishte deklaruar pakësimin e shumës 800.000 lekë, si dhe gjatë vitit 2015 ishte pakësuar sërish dhe më datë 23.02.2016, gjendja cash ka qenë 1.300.000 lekë. Mosdeklarimi i pakësimit të gjendjes cash, e deklaruar pranë ILDKPKI-së më datë 23.02.2016, ka qenë një pakujdesi e bashkëshortit, por pa pasur si qëllim fshehjen e pasurisë apo të burimit të saj. Në këto kushte, kjo pasaktësi nuk mund të shërbejë për marrjen e masës disiplinore.*

**15.9** Fakti që subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), trajton në shpjegimet e saj se këto pasaktësi janë deklaruar edhe pranë ILDKPKI-së, nuk ka efekt në drejtim të sjelljes së subjektit ndaj detyrimeve ligjore në fuqi. Subjekti është kontradiktor edhe mes deklarimeve në procesverbalet e dhëna brenda një kohe shumë të shkurtër, duke përfshirë këtu edhe deklaratat periodike dhe qëndrimin e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit në Komision e në Kolegj, prandaj ato janë të pabesueshme dhe e humbin vlerën provuese.

**15.10** Kolegji vëren se duke vlerësuar deklaratat periodike dhe ato të para fillimit të detyrës, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), dhe bashkëshorti i saj, për gjendjen *cash* 1.400.000<sup>7</sup> lekë, nuk kanë deklaruar pakësim ndër vite, si një detyrim që rrjedh nga ligji nr. 9049/2003, si rrjedhojë kjo gjendje *cash* mbetet e paqartësuar se kur është shpenzuar. Edhe gjatë shqyrtimit në Kolegj, rezultoi se nuk është deklaruar pakësim në deklaratat periodike, përveçse në procesverbalin e ILDKPKI-së, kur është pyetur për gjendjen *cash* prej 4.000.000 lekësh të bashkëshortit të saj, cituar në paragrafin 15.6 më sipër. Sipas shpjegimeve në ILDKPKI dhe në Komision, subjekti i rivlerësimit, ashtu dhe bashkëshorti i saj kanë harruar për të deklaruar shpenzimet prej 600.000 lekësh në vitin 2013 nga ana e subjektit, dhe shpenzimet prej 800.000 lekësh në vitin 2014 nga bashkëshorti i saj. Duke u nisur nga këto sqarime të subjektit të rivlerësimit, rezulton se as në deklaratat periodike të periudhës 2008 deri 2012, nuk janë deklaruar shtesa apo pakësime të gjendjes *cash* prej 600.000 lekësh, jashtë sistemit bankar, të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si të shpenzuar në vitin 2013. E thënë ndryshe, në funksion të procesit të rivlerësimit në Kolegj, përkundër mospërputhjeve të konstatuara në deklarinmet e subjektit të rivlerësimit ndër vite, të cilat shërbejnë si bazë për të vlerësuar deklaratën e saj të pasurisë *vetting*, nëpërmjet shpjegimeve të dhëna në Komision, por edhe në Kolegj, subjekti pretendon se ka shpenzime të padeklaruara ndër vite, ndaj nga ky pretendim rrjedh se gjendja e *cash-it* të deklaruar në deklarime periodike, nuk ishte reale.

---

<sup>7</sup> 800.000 lekë bashkëshorti i subjektit + 600.000 lekë të subjektit të rivlerësimit të deklaruara para fillimit të detyrës.

**15.11** Kolegji sjell në vëmendje se pavarësisht nga ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarimit, në rubrikën përkatëse, faqja 3 e formularit, që i përket pasqyrimit të shtesave dhe ndryshimeve të interesave privatë dhe pasurive të paluajtshme e të luajtshme, ligji në mënyrë konsistente ka kërkuar që subjektet deklaruese të shprehen për “[...] ndryshimet (shtesa dhe pakësime)” nga “deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit” që lidhen me zyrtarin, bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë [...]”. Legjislacioni në fuqi ka qenë i qartë duke parashikuar që deklaratat përbëjnë dokumente zyrtare dhe mospërmbushja e këtij detyrimi sillte pasoja për subjektet deklaruese.

**15.12** Nga rrethanat dhe faktet më sipër, Kolegjit i rezultoi se argumentet e subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), bien ndesh me detyrimet e saj gjatë procesit të rivlerësimit, të përcaktuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës, për të deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj dhe të personave të lidhur, në funksion të vazhdimit të qëndrimit në detyrë, sikurse edhe me detyrimet ligjore të subjektit si funksionar publik/subjekt i ligjit nr. 9049/2003. Konkretisht, plotësimi me saktësi dhe vërtetësi i deklaratës *vetting* ka rëndësi në zbatimin e duhur të kuadrit ligjor (neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016<sup>8</sup>), si dhe nënligjor (udhëzimi nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, i ILDKPKI<sup>9</sup>-së). Këto rregullime kërkojnë që subjektet e rivlerësimit të deklarojnë me vërtetësi pasurinë, në rastin konkret likuiditete *cash* jashtë sistemit bankar, të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit dhe të mos ketë përpjekje për fshehje apo pasqyrim të pasaktë. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se këto kursime në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, shtesat dhe pakësimet e tyre, duke pasur në konsideratë edhe faktin që subjekti i rivlerësimit ka pasur qëndrime kontradiktore lidhur me to edhe në deklaratat që ka dhënë para ILDKPKI-së, do të përlllogariten duke vlerësuar deklaratat e subjektit dhe të personave të lidhur me të në deklaratat periodike/vjetore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

**15.13** Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues vëren se nga praktika<sup>10</sup> e konsoliduar e Kolegjit, rezulton se, bazuar në ligjin nr. 9049/2003, në nenin 4, shkronja “d”, parashikohet se subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve. Pasaktësitë, për të cilat subjekti justifikohet me harresë në shpjegimet gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe në procesverbalet në ILDKPKI, sipas dokumentacionit në dosje,

---

<sup>8</sup> Neni 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit parashikon: “[...] a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi [...]”.

<sup>9</sup> Udhëzimi “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” – pika 17: “Deklarimi i gjendjes “cash” do të njihet si i tillë në konceptin e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, deri në kufirin e shumës 1,5 milionë lekë. Shumat më të mëdha duhet të formalizohen në sistemin bankar, përpara dorëzimit të deklaratës në ILDKPKI, duke bashkëlidhur në çdo rast vërtetimin bankar për këtë veprim”.

<sup>10</sup> Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 20/2020, datë 08.09.2020, paragrafi 19.4.

vërtetësia e të cilave mbetet e pamundur për t'u verifikuar, rezulton se shoqërohen me mungesën e burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë, ndaj nuk konsiderohen si të tilla pikërisht për shkak se përfaqësojnë në fakt, mungesë të konsiderueshme burimesh financiare të krijimit të pasurisë së ligjshme. Si rrjedhojë e sa më sipër, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, siç arsyetohet në vijim të këtij vendimi.

16. Në lidhje me *mjaftueshmërinë dhe burimin e ligjshëm* të krijimit të likuiditeteve *cash* në shumën 4.000.000 lekë, për të cilën Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk rezulton ta kenë përdorur gjendjen *cash* prej 4.000.000 lekësh për të investuar në pasuri të tjera, përveçse për blerjen e automjetit me targë {\*\*\*}, Komisioneri Publik, ndryshe nga Komisioni, pretendoi se, bazuar në aktet e administruara në dosje, kursimet *cash* kanë shërbyer si burim krijimi për pasuritë e krijuara pas martesës së subjektit të rivlerësimit me z. A. P., të renditura si më poshtë:

- automjet, tip “Mercedes Benz”, me targa {\*\*\*};
- llogari bankare në ABI Bank, në shumën 1.300.000 lekë;
- llogari bankare në emër të subjektit të rivlerësimit, në Raiffeisen Bank, me balancë në datën 31.12.2016, në shumën 1.774.148,61 lekë;
- llogari bankare në ABI Bank, në shumën 1.505,1 euro.

Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë likuiditete *cash*, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, në lidhje me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Komisioneri Publik vlerëson gjithashtu se referenca e Komisionit të parimi i “proporcionalitetit” për të justifikuar moszbatimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në arsyetimin e vendimit, lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar, nuk gjen mbështetje në kuadrin kushtetues dhe ligjor.

16.1 Kolegji vëren se në pyetësorin standard të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se bashkëjetesën me bashkëshortin e saj e ka filluar në janar të vitit 2012. Në deklaratën e vitit 2013, vit në të cilin personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit deklaroi për herë të parë, ai ka deklaruar likuiditete *cash* në vlerën 4.000.000 lekë, me burim të ardhurat nga puna ndër vite, prej vitit 1998. Komisioni arsyetoi se duke qenë se nuk disponohet informacion lidhur me vlerën e saktë të likuiditeteve *cash* të bashkëshortit gjatë bashkëjetesës me subjektin, i cili është përdorur nga subjekti dhe bashkëshorti në vitet paraardhëse, si dhe dy nga automjetet e deklaruara në DIPP-në e vitit 2013 janë blerë pas lidhjes në martesë, vlerësoi të kryejë analizën financiare për burimet e ligjshme për pasuritë e deklaruara në DIPP-në e vitit 2013, duke përlllogaritur: (1) të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e bashkëshortit për periudhën 2001 – 2013; dhe (2) të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit për periudhën 2012 – 2013.

16.1.1 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, kërkoi nga Komisioni të vlerësojë të drejtë konkluzionin e nxjerrë nga audituesi ligjor në aktin e ekspertimit të dorëzuar nga subjekti pas daljes së rezultateve të hetimit, duke vlerësuar se marzhi i fitimit për gjithë

periudhën 2001-2013, duhet të përlogaritet si një mesatare e përgjithshme në masën 25,54% dhe jo në masën 18,31%, siç e ka llogaritur Komisioni. Në këtë mënyrë, analiza financiare dhe mundësia e kursimit të bashkëshortit tregohet dhe pasqyrohet më me saktësi. Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, Komisioni vlerësoi të aplikojë një marzh fitimi në masën 25,54%, për vitet 2001 – 2006, vite për të cilat nuk ka informacion nga organet kompetente lidhur me fitimin e realizuar me arsyetimin se një marzh i tillë është i pranueshëm për llojin e aktivitetit (tregti e mallrave industriale) që ushtron bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Pavarësisht se në raportin e audituesit ligjor është aplikuar norma e fitimit 25,54% edhe në vitet për të cilat ka të dhëna, Komisioni vlerësoi që fitimi për këto vite, të mbetet i pandryshuar në shumën totale prej 2.042.120 lekësh, për sa kohë që Bashkia Lushnjë, për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2012 dhe 2013, ka përcjellë informacion të mjaftueshëm për përcaktimin e fitimit. Ndërsa për vitin 2011, Komisioni vlerësoi të aplikojë një normë fitimi prej 23,81%, si mesatare e normës së fitimit të vitit paraardhës dhe vitit pasardhës, duke arritur në rezultatin e përlogaritur të një fitimi në shumën 416.815 lekë. Në Kolegj, u aplikua e njëjta metodikë e përlogaritjes së normës së fitimit për biznesin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për vitet si më sipër në këtë paragraf.

**16.1.2** Komisioneri Publik në parashtrimet e dorëzuara në seancë gjyqësore në Kolegj pretendoi se, megjithëse Komisioni në analizën financiare përfundimtare ka pranuar të marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me një marzh më të lartë fitimi nga aktiviteti tregtar i z. A. P., sërish ka rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve financiare në vlerën -1.648.646 lekë, për pasuritë e deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur me të, në DIPP-në e vitit 2013. Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e dorëzuara në Kolegj lidhur me këto rrethana, ka shpjeguar se gjendja e *cash*-it ka qenë pasuri personale e bashkëshortit e krijuar përpara martesë, e cila është administruar gjithmonë prej tij, prandaj, pas konsultimit me bashkëshortin, i është shpjeguar subjektit se në vitin 2014, kishte pakësuar shumën prej 800.000 lekësh, pasaktësi e këtij viti, për të cilën subjekti pretendoi në seancë gjyqësore publike, se nuk mund të shërbejë për marrjen e masës disiplinore.

**16.1.3** Në Kolegj, u krye analiza financiare për të llogaritur mundësinë e kursimit të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2001-2013, pasi dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, dokumenton fillimin e aktivitetit tregtar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në vitin 2001, dhe në vitin 2013 është deklaruar për herë të parë prej tij si person i lidhur me subjektin e rivlerësimit, gjendja *cash* (4.000.000 lekë). Nga analiza ekonomike e kryer në Kolegj për periudhën 2001-2013, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), dhe bashkëshorti i saj nuk kishin mundësi të krijojnë shumën 4.000.000 lekë për diferencën negative 1.648.646 lekë. Pra, mundësia e kursimit nga ana e bashkëshortit të subjektit, deri në vitin 2013, do të ishte në shumën 2.351.354 lekë. Pasuritë e analizuar më poshtë, janë marrë në shqyrtim nga Kolegji për mundësinë e krijimit në vitet përkatëse, për shkak se janë krijuar me burime sipas deklarimeve të subjektit dhe të personit të lidhur me të, nga të ardhura të krijuara nga biznesi ndër vite. Në Kolegj, u krye analiza financiare duke konsideruar shumën 2.351.354 lekë si kursim në vitin 2013, nga e cila, situata financiare për vitet 2013, 2014, 2015, 2016 do të ishte si vijon.

**16.1.4** Për të verifikuar mundësinë e krijimit të pasurisë automjet, tip “Mercedes Benz”, me targa {\*\*\*}, blerë në vitin 2014, të cilin bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e ka deklaruar të blerë në Gjermani, në vlerën 4.300 euro, dhe shpenzimet doganore në shumën 383.000 lekë, Kolegji kreu analizën financiare, nga e cila rezultoi se deri në datën 14.04.2014, data e blerjes së automjetit, subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), dhe bashkëshorti i saj, për kryerjen e shpenzimeve, krijimin e kursimeve, si dhe blerjen e automjetit, rezultojnë me diferencë negative në shumën -1.332.391 lekë.

**16.2** Lidhur me pasurinë automjet, tip “Mercedes Benz”, me targa {\*\*\*}, Kolegji vëren se Komisioni arriti në konkluzionin se, duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash*, kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur deri në datën 31.12.2015 dhe rezultoi se kanë pasur burime të ligjshme financiare për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive në vitin 2015.

**16.2.1** Në deklaratën *vetting*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar automjet furgon, tip “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*}, blerë sipas kontratës së shitjes, datë 08.10.2015, me vlerë 8.400 euro, me burim të ardhurat nga biznesi ndër vite. Sipas dokumentacionit të administruar në dosje, ky automjet është shitur nga B. K., person fizik me NIPT {\*\*\*}, i cili ushtron aktivitet tregtimi automjetesh, dhe blerës A. P., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ndaj dhe kontrata e shitjes nuk është lidhur para noterit, por vetëm ndërmjet palëve.

**16.2.2** Në DIPP-në e vitit 2015, në rubrikën e ndryshimit të pasurive, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaroi “blerje automjeti , furgon “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*}, nga kursimet personale, në vlerën 8500 euro, si dhe në vijim të deklarimit të këtij viti, bashkëshorti i subjektit deklaroi pakësim të gjendjes së të ardhurave *cash*, blerje automjeti dhe shpenzime të ndryshme familjare 1.900.000 lekë.

**16.2.3** Kolegji vëren se, sipas dokumentacionit të administruar nga DPSHTRR, konfirmohet<sup>11</sup> se automjeti, tip “Mercedes Benz”, viti i prodhimit 2008, me targë {\*\*\*}, është i regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, blerë me faturë tatimore shitje me nr. {\*\*\*}, datë 08.10.2015, me kontratën e shitjes (jo para noterit), datë 08.10.2015, blerë nga personi fizik B. K., me NIPT {\*\*\*}, në vlerën 8.400 euro. Si burim krijimi, bazuar në deklaratimet e personit të lidhur, kanë shërbyer likuiditetet *cash* të deklaruara (4.000.000 lekë) në DIPP-në e vitit 2013. Më tej, ky mjet i është shitur shtetasit E. Ç., me anë të kontratës nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. kol. {\*\*\*}, datë 30.11.2017, në vlerën 1.500.000 lekë, deklaruar edhe në DIPP-në e vitit 2017.

**16.2.4** Në vitin 2015, është pakësuar gjendja e *cash*-it në shumën 1.900.000 lekë, sipas deklarimit në DIPP-në e këtij viti, i cili u konsiderua në analizën financiare të kryer në Kolegji për vitin 2015, nga e cila rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), dhe personi i lidhur, bashkëshorti i saj, kanë pasur mundësi të kryejnë blerjen e kësaj pasurie dhe të përballojnë shpenzimet që i përkasin këtij viti.

---

<sup>11</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.12.2019.

**16.3** Lidhur me llogarinë bankare në ABI Bank, në shumën 1.300.000 lekë, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit, rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar në datën 22.02.2016, vlerën 1.300.000 lekë, me përshkrimin: “Derdhur nga A. P., të ardhura nga kursimet”. Në datën 24.03.2016, kjo shumë është tërhequr me përshkrimin: “A. P., tërheqje për shpenzime”.

**16.3.1** Kjo llogari bankare dhe burimi i krijimit të saj nuk rezultojnë që të jenë deklaruar në DIPP-në e vitit 2016, por është deklaruar vetëm si pakësim i kursimeve në vlerën 1.300.000 lekë, ndërsa në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, më datë 23.02.2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se gjatë vitit 2015, është pakësuar sërish gjendja *cash*, pakësim të cilin subjekti ka shpjeguar se do e deklarojë në vitin e ardhshëm. Subjekti ka sqaruar se në momentin e hartimit të këtij procesverbali, gjendja *cash* është depozituar në bankë, në shumën 1.300.000 lekë.

**16.3.2** Sa më sipër, lidhur me këtë llogari bankare, vlera prej 1.300.000 lekësh është depozituar dhe tërhequr nga banka brenda një periudhe të shkurtër kohore (një muaj) përpara plotësimit të deklaratës *vetting*. Në parashtrimet e dorëzuara në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), ka shpjeguar se në analizën e paraqitur prej saj në parashtrimet e çështjes, rezulton një balancë negative në shumën 248.642 lekë. Kjo, shpjegon subjekti, është e vetmja balancë negative e të gjitha pasurive që kanë si burim gjendjen *cash* të përlllogarit me burime financiare të ligjshme dhe të tatuara, e cila mund të shpjegohet nga fakti që gjendja *cash* e bashkëshortit miksohet me gjendjen *cash* të personit fizik tregtar.

Nga analiza financiare e kryer në Kolegj për krijimin e depozitës në ABI Bank, në datën 23.02.2016, rezultoi se pas pakësimit të kursimeve *cash* në shumën 1.051.354 lekë, e mbetur nga viti 2015, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar krijimin e kësaj depozite dhe përballimin e shpenzimeve të tjera për diferencën negative 223.945 lekë.

**16.4** Lidhur me llogarinë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit, në Raiffeisen Bank, me balancë në shumën 1.774.148.61 lekë, në datën 31.12.2016, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari dhe identifikohen qartë transfertat nga paga, duke verifikuar kështu burimin e ligjshëm të kësaj llogarie.

**16.4.1** Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Llogari rrjedhëse në lekë pranë Raiffeisen Bank [...]. Të ardhura të krijuara nga kursimet nga puna dhe bursa që prej vitit 2004, vlera 1.316.666 lekë”.

Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti deklaroi: “Llogari rrjedhëse pranë Raiffeisen Bank, e krijuar nga të ardhurat nga paga [...] 695.724 lekë”.

Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti deklaroi: “Shtesë likuiditeti, llogari rrjedhëse pranë Raiffeisen Bank, e krijuar nga të ardhurat nga paga, 544.927 lekë”.

Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti deklaroi: “Shtesë e llogarisë rrjedhëse pranë Raiffeisen Bank, e krijuar nga të ardhurat nga paga, 736.143 lekë”.



Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti deklaroi: “Pakësim në llogarinë rrjedhëse pranë Raiffeisen Bank, 202.610 lekë”.

**16.4.2** Komisioneri Publik, lidhur me këtë llogari bankare, ka parashtruar në ankim se balanca e kësaj llogarie në datën 31.12.2016, është në shumën 1.774.148,61 lekë. Kursimet në këtë llogari bankare janë krijuar gjatë periudhës 2012 - 2016 dhe kanë si burim të ardhurat nga punësimi i subjektit të rivlerësimit. Konkretisht, në vitin 2015, nga të ardhurat e realizuara nga punësimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), në shumën totale prej 922.298 lekësh, janë shtuar likuiditete në llogarinë e saj bankare, në shumën 736.143 lekë. Si rrjedhojë, argumenton Komisioneri Publik, duke mbajtur në konsideratë se pjesa më e madhe e të ardhurave nga paga e subjektit kanë shërbyer për shtimin e likuiditeteve në këtë llogari bankare, rezulton se kursimi i kësaj shume nuk do të ishte i mundur, nëse nuk do të mbulohehin shpenzimet e tjera të familjes nga pakësimi i likuiditeteve *cash*, siç është deklaruar përkatësisht në DIPP-në e vitit 2015.

**16.4.3** Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se llogaria bankare pranë Raiffeisen Bank është një llogari page, e cila kreditohet kryesisht nga paga, shpërblime dhe interesa bankarë. Kjo llogari është krijuar në nëntor të vitit 2005. Llogaria ka filluar të ketë tepricë kreditore në vitin 2012. Përpara këtyre viteve, subjekti ka rezultuar me diferencë debitore nga kjo llogari për shkak të konsumimit të *overdraft*-it. Sa më sipër, të ardhurat e krijuara nga Shkolla e Magjistraturës, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit se kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj llogarie, nuk mund të kenë shërbyer për krijimin e kursimit në këtë llogari, duke qenë se në vitet kur subjekti i rivlerësimit ka kryer studimet në Shkollën e Magjistraturës, llogaria ka pasur diferencë debitore. Si rrjedhojë e sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se nuk përputhet situata faktike me deklarin e subjektit të rivlerësimit, lidhur me burimin e krijimit të depozitës, pasi kjo llogari ka filluar të kreditohet në vitin 2012, pas përfundimit të studimeve të magjistraturës nga subjekti i rivlerësimit, si rrjedhojë nuk përputhet kreditimi i llogarisë me momentin e krijimit të këtyre të ardhurave që, sipas subjektit, kanë shërbyer për krijimin e depozitës.

**16.5** *Llogari bankare në ABI Bank, në shumën 1.505,1 euro*, për të cilën Komisioni vlerësoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari dhe ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga aktiviteti i tij tregtar, pra, provohet burimi i ligjshëm i kësaj llogarie.

**16.5.1** Në deklaratën *vetting*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, si person i lidhur, ka deklaruar llogari bankare pranë American Bank of Investments, me vlerë 1.505,1 euro. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi, deklaroi kursime nga të ardhurat e krijuara nga biznesi. Për vërtetimin e deklarinave, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion provues, saktësisht vërtetimin e datës 27.01.2017, lëshuar nga ABI Bank.

**16.5.2** Komisioneri Publik ka argumentuar në ankim lidhur me këtë llogari bankare, se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), dhe të bashkëshortit të saj, për periudhën 01.01.2015 – 01.04.2015, nuk janë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve familjare dhe për

të kursyer shumën 1.500 euro, pasi, referuar akteve të administruara në dosje të Komisionit, rezulton se subjekti gjatë kësaj periudhe ka tërhequr *cash* nga llogaria e saj në Raiffeisen Bank, në total, shumën 58.000 lekë, ndërsa fitimi i bashkëshortit për këtë periudhë, llogaritet në shumën rreth 100.000 lekë. Për rrjedhojë, Komisioneri Publik vlerëson se krijimi i kësaj llogarie bankare rrjedh nga pakësimi i likuiditeteve *cash*.

**16.5.3** Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e dorëzuara në Kolegj gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancë publike, shpjegoi se në analizën financiare të vitit 2015, ku përfshihet edhe vlera prej 1.505,1 eurosh, e depozituar nga bashkëshorti në llogarinë e tij, balanca e këtij viti rezulton pozitive. Subjekti i rivlerësimit thekson se për llogaritjet janë kryer duke konsideruar në analizë vetëm gjendjen *cash* të mbuluar nga të ardhurat e ligjshme dhe të tatuara.

**16.5.4** Kolegji vëren se nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit, në llogarinë e Raiffeisen Bank, ku kreditohet paga e subjektit të rivlerësimit, rezulton se për periudhën janar - mars 2015, subjekti i rivlerësimit ka kryer nga kjo llogari pagesa për shpenzime të ndryshme familjare dhe tërheqje *cash*. Nga analiza financiare mes të ardhurave dhe shpenzimeve deri në momentin e krijimit të depozitës në shumën 1505,1 euro në ABI Bank, rezultoi se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), dhe bashkëshortit të saj janë të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe për krijimin e depozitës pranë kësaj banke. Shpenzimet e jetesës për tre muaj në vitin 2015, janë 186.897 lekë për familjen e subjektit të rivlerësimit. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitet 2015 dhe 2016, subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë pozitive ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, si rrjedhojë subjekti kishte mundësi të krijonte kursimin në llogarinë e ABI Bank, si dhe të përballonte shpenzimet për këto vite.

**16.5.5** Në përfundim të shqyrtimit të shkakut të ankimit lidhur me mjaftueshmërinë dhe burimin e ligjshëm të krijimit të likuiditeteve *cash* në shumën 4.000.000 lekë të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, Kolegji arriti në konkluzionin se nga analiza financiare e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit rezultoi me diferencë negative në vlerën 377.355 lekë. Në lidhje me krijimin e pasurive automjet, tip “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*}, dhe depozitën në shumën 1.300.000 lekë në ABI Bank, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, trupi gjykues arriti në konkluzionin se deri në momentin e krijimit të këtyre pasurive, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të krijojë këto pasuri për diferencën negative në shumën 1.556.336 lekë, si rrjedhojë ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive në kuptim të nenit nr. 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 17.** Lidhur me pasurinë *automjet, tip “Mercedes Benz”, me targa {\*\*\*}*, Komisioneri Publik pretendoi se, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, të ndryshuar, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur detyrimin ligjor për të deklaruar pasuritë në pronësi dhe burimin e krijimit të tyre. Nga analizimi i deklaratës periodike për vitin 2014, nuk rezulton të jetë deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie apo pakësimi i likuiditeteve *cash* të disponuara. Për rrjedhojë, sikurse dhe Komisioni ka konstatuar, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pamjaftueshmëri në momentin e blerjes së kësaj pasurie, në shumën prej -1.386.783 lekësh. Në kuadrin e kontrollit të kriterit të pasurisë dhe vlerësimit tërësor të çështjes, pamjaftueshmëria e

burimeve të ligjshme në krijimin e kësaj pasurie do të rezultonte edhe nëse marrim në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit: “[...] se mosndryshimi i gjendjes *cash* nuk do të thotë se gjatë vitit kjo gjendje nuk ka ndryshuar [...]” në fund të vitit 2014, për një diferencë negative në vlerën - 352.255 lekë. Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për krijimin e kësaj pasurie, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, në lidhje me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**17.1** Komisioni, lidhur me këtë pasuri, ka arsyetuar si vijon: “Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaramat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se: [...] Në përfundim, subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 352.255 lekë, për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2014”.

**17.2** Kolegji vëren se në DPPP-në e vitit 2014, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar blerje automjeti “Mercedes Benz” në Gjermani, me targë {\*\*\*}, në vlerë 4.300 euro dhe shpenzimet doganore në shumën 383.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Më poshtë, në të njëjtën deklaratë, deklaron shitjen e këtij automjeti në vlerën 9.000 euro. Nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie.

**17.3** Sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit në shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.12.2019, të DPSHTRR-së, nuk rezultojnë të dhëna për këtë automjet. Gjithashtu, nga kontrolli i kryer nga Komisioni në sistemin e AMF-së, ky automjet nuk figuron në pronësi të z. A. P.

**17.4** Subjekti i rivlerësimit është pyetur nga Komisioni në pyetësorin standard, nëse ka pasur shpenzim më të lartë se 2500 euro, pyetje së cilës subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur: “Bashkëshorti ka blerë automjetin, tip “Mercedes Benz”, me targa {\*\*\*}, për një vlerë 4.300 euro në Gjermani dhe pagesa e doganës 383.000 lekë. Automjeti është shitur në vitin 2014, për një vlerë 9.000 euro. Dua të sqaroj se këtë automjet fillimisht ia ka shitur shtetasit M. C., për një vlerë 12.000 euro. Pas blerjes, blerësi kishte pretendime lidhur me mjetin dhe nuk ishte dakord për veprimin e kryer. Automjeti është rishitur për një vlerë 9.000 euro, që është vlere reale e shitjes dhe e deklaruar në deklaratën periodike. Blerë me të ardhurat nga kursimet e bashkëshortit. Pagesa është bërë menjëherë me blerjen e mjetit”.

**17.5** E pyetur lidhur me këtë automjet në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së, datë 29.01.2016, subjekti ka sqaruar se do të paraqesë dokumentacionin e kërkuar. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, më datë 23.02.2016, subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë automjet, ka sqaruar se paraqet faturën e blerjes së këtij mjeti.

**17.6** Kolegji vëren se Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.12.2020, ka përcjellë në Komision deklaratën doganore nr. {\*\*\*}, datë 14.04.2014, me të dhënat: marrës A. P., çmim blerje 5.300 euro dhe shpenzime doganore 341.448 lekë. Nga hetimi i Komisionit, rezultoi se pranë zyrës së noterit G. B., shkresë e protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*}, datë 10.06.2020, është lidhur kontrata e shitjes së këtij automjeti, me nr. rep. {\*\*\*}, dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 10.06.2014, me palë shitëse bashkëshortin e subjektit A. P. dhe blerësin M. C., kundrejt çmimit 12.000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

**17.7** Me anë të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për shitjen përfundimtare të këtij automjeti. Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur sqarimeve që ka dhënë, ka bashkëlidhur kontratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol. datë 09.09.2014, e lidhur para noterit A. K., me palë shitëse shtetasin M. C. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se ashtu siç ka deklaruar edhe më parë, automjeti në fjalë i është shitur fillimisht shtetasit M. C., për një vlerë 12.000 euro. Duke qenë se ky shtetas kishte pakënaqësi lidhur me mjetin, e ka kthyer atë pak ditë pas blerjes dhe ka rimarrë pagesën e kryer për automjetin, prej 12.000 eurosh. Për këtë veprim nuk është bërë kontratë tjetër noteriale, duke qenë se automjeti do të nxirrej përsëri në shitje. Për këtë arsye, në momentin që është shitur automjeti, pronar dhe palë shitëse e automjetit figuron shtetasi M. C. Vlera finale e shitjes ka qenë 9.000 euro.

**17.8** Kolegji vëren se sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., z. M. C. ia ka shitur këtë mjet blerësit Sh. M. në vlerën 9.000 euro. Por subjekti nuk ka paraqitur dokument provues ligjor lidhur me deklaratimet e tij dhe kthimin e shumës prej 12.000 eurosh shtetasit M. C., pas lidhjes së kontratës së parë të shitjes më datë 10.06.2014.

**17.9** Për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie, në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar që ky automjet është blerë me të ardhurat nga kursimet e bashkëshortit. Në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2014, subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti nuk kanë deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe as përdorimin e likuiditeteve *cash* për blerjen e automjetit (në fund të vitit 2013, gjendja *cash* e deklaruar nga ana e bashkëshortit ka qenë 4.000.000 lekë).

**17.10** Nga faktet e analizuar më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) lidhur me ligjshmërinë e burimit financiar për blerjen e këtij automjeti, Komisioni kreu analizën financiare në datën 14.04.2014, nga ku rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit në këtë datë, me një balancë negative prej 1.386.783 lekësh; (ii) referuar analizës financiare në datën 31.12.2014, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë vitit 2014, me një balancë negative prej 352.255 lekësh; (iii) ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues lidhur me vlerën reale të shitjes së automjetit me targa {\*\*\*} dhe deklaratimeve të subjektit për kthimin e shumës prej 12.000 eurosh shtetasit M.C., pas lidhjes së kontratës së parë të shitjes në datën 10.06.2014; (iv) ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti.

**17.11** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit lidhur me barrën e provës për këtë pasuri, është përgjigjur: “Në lidhje me konstatimet e Komisionit, deklaroj se së pari, bashkëshorti ka pasur likuiditet të mjaftueshëm për ta përdorur brenda vitit për blerjen e automjetit. Në DPV-në e vitit 2014, ka një pasaktësi sepse nuk është deklaruar zvogëlimi i gjendjes *cash*. Edhe nëse në një moment e marrim të pandryshuar gjendjen e *cash*-it në fund të vitit 2014, kjo nuk do të thotë që gjatë vitit kjo gjendje s’ka ndryshuar. Ndonëse nuk është shprehur nga ana ime në mënyrë eksplicite, nga pakësimi i gjendjes *cash*, por kuptohet fare qartë se kursimet janë *cash*-i i disponuar nga bashkëshorti. Të ardhurat e realizuara deri në datën 14.04.2014, janë më të ulëta se vlera e blerjes së automjetit. Në këtë kuptim, përdorimi i termi “kursimet e bashkëshortit” u referohet kursimeve në *cash* që bashkëshorti dispononte në atë moment dhe jo kursimeve nga data

01.01.2014 deri në 14.04.2014. Për këtë arsye, Komisioni duhet të përfshijë në analizën financiare, kryer në momentin e blerjes së automjetit, pakësimin e gjendjes *cash* si burim krijimi për blerjen e automjetit. Edhe sikur në fund të vitit KPK të konsiderojë të pandryshuar gjendjen e *cash*-it, në datë 14.04.2014 kjo gjendje ka ndryshuar. Duke qenë se gjendja e *cash*-it më datë 14.04.2014, e disponuar nga bashkëshorti, ka qenë më e lartë se vlera e automjetit, është e qartë se në këtë datë, bashkëshorti ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e tij”.

**17.12** Për të parë mundësinë e blerjes së këtij automjeti, në Kolegj u krye analiza financiare për periudhën 01.01.2014 - 14.04.2014 (deri në momentin e blerjes). Për kryerjen e kësaj analize, u fragmentuan të ardhurat, shpenzimet dhe llogaritë bankare deri në datën e blerjes së automjetit. Në analizën e kryer në Kolegj, çmimi i blerjes së automjetit u përlllogarit në vlerën 5.300 euro, duke shtuar edhe shpenzimet doganore në vlerën 341.448 lekë, sipas të dhënave të pasqyruara në deklaratën doganore, pavarësisht se në DIPP-në e vitit 2014, nga personi i lidhur është deklaruar çmimi i blerjes 4.300 euro.

**17.13** Sa më sipër, lidhur me automjetin objekt vlerësimi, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues lidhur me vlerën reale të shitjes së automjetit me targa {\*\*\*} dhe deklarimeve të subjektit për kthimin e shumës prej 12.000 eurosh shtetasit M.C., e cila nuk rezultoi e dokumentuar me kontratë, por as me mandat bankar. Referuar analizës financiare për krijimin e pasurisë automjet, tip “Mercedes Benz”, me targa {\*\*\*}, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur mundësi të krijojnë pasurinë automjet dhe të përballonin shpenzimet e tyre për periudhën 01.01.2014 - 14.04.2014, për vlerën 1.332.391 lekë. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

**17.14** Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për aplikimin e parimit të proporcionalitetit nga Komisioni, Kolegji vlerësoi se nga dispozitat ligjore të parashikuara nga Kushtetuta, por edhe nga ligji nr. 84/2016, vërehet se ato i referohen aplikimit të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit për zgjidhjen e çështjes në tërësi, duke synuar që në rastet objekt vlerësimi në kuadër të rivlerësimit të subjekteve të këtij ligji, masa disiplinore e dhënë të jetë në përpjesëtim të drejtë me shkeljet e konstatuara. Në rastin e procesit të rivlerësimit, aplikimi i parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit nga organet e rivlerësimit, i çon këto organe drejt dhënies së një mase disiplinore e cila nxjerr subjektet jashtë sistemit të drejtësisë, bazuar vetëm në standarde objektive, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit, si dhe duke vlerësuar që masa e dhënë të jetë në proporcion me shkeljet e konstatuara.

**17.15** Në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor”. Në nenin 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, te “Barra e provës”, parashikohet se Komisioni dhe Kolegji, në shqyrtimin e çështjes, udhëhiqen nga parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit. Sipas dispozitave referuese, parimet e proporcionalitetit dhe objektivitetit orientojnë vlerësimin në tërësi të çështjes, me synimin që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Për më tepër, neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës parashikon kalimin e barrës së provës subjektit të rivlerësimit vetëm në këtë proces administrativ, duke u përjashtuar nga çdo proces tjetër, në veçanti ai penal.

**17.16** Nga analizimi i këtyre dispozitave dhe praktika<sup>12</sup> e konsoliduar e Kolegjit, rezulton se proporcionaliteti është një pjesë e tërësisë së parimeve nga të cilat udhëhiqen institucionet e rivlerësimit dhe ai nuk mund të gjejë zbatim si një parim i veçantë dhe i vetëm. Në vlerësimin e Kolegjit, duke shqyrtuar edhe rezultatet e analizës financiare të kryer në Kolegj, trupi gjykues çmoi se rëndësia e shkeljes është e tillë që nuk lejoi zbatimin e parimit të proporcionalitetit, pasi pasaktësitë në deklaram të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të konstatuara ndër vite, si dhe në deklaratën *vetting*, pamundësuan kontrollin e kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, duke çuar trupin gjykues të arrijë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti një nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

- 18.** Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes së gjykuar në seancë gjyqësore publike për subjektin e rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), pasi dëgjoi edhe konkluzionet përfundimtare të Komisionerit Publik dhe të subjektit të rivlerësimit, vlerësoi të gjitha shkaqet e ankimit në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore të përbërë nga aktet e përcjella në Kolegj nga Komisioni dhe parashtrimet e depozituara nga palët gjatë seancave publike, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionet e mëposhtme.

**18.1** Kolegji vlerësoi se deklaramet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash*, në shumën 4.000.000 lekë, dhe përdorimin e tyre, deklaramet kontradiktore në procesverbalet e ILDKPKI-së për gjendjen e likuiditeteve *cash*, të deklaruar vetëm me një muaj diferencë, në deklaratat periodike në ILDKPKI, si dhe gjatë procesit të rivlerësimit në Komision e Kolegj, e vënë subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke pamundësuar kontrollin objektiv dhe në tërësi të kriterit të pasurisë dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk arriti një nivel të besueshëm lidhur me vlerësimin e pasurisë së tij.

**18.2** Bazuar në rrethanat specifike të çështjes në shqyrtim, trupi gjykues konstatoi mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e automjetit, tip “Mercedes Benz”, me targë {\*\*\*}, blerë në vitin 2014, si dhe depozitimit të shumës 1.300.000 lekë në ABI Bank, në vitin 2016. Në çdo version të analizës financiare të kryer në Kolegj, duke konsideruar si kursim të mundshëm shumën prej 2.351.358 lekësh, të konstatuar nga Komisioni, si dhe të pranuar në seancë gjyqësore në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), ajo rezultoi me pamundësi financiare të tillë, që nuk mund të lejonte zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe, për pasojë, të sillte konfirmimin e saj në detyrë.

**18.3** Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, shoqëruar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe krijimin e këtyre pasurive, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

- 19.** Për rrjedhojë, bazuar në konkluzionet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në kontrollin e pasurisë, bazuar në nenin 58, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 392, datë 28.05.2021, për

---

<sup>12</sup> *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 2/2020, datë 27.02.2020; nr. 20/2020, datë 08.09.2020; nr. 36/2020, datë 16.12.2020.*

konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit duhet ndryshuar, pasi nuk gjendet i drejtë e i bazuar në fakte, prova dhe ligj.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 392, datë 28.05.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi).
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 04.07.2022, në Tiranë.

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi – kundër*

#### **KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e relatores së çështjes, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, kam votuar kundër kërimit të ankimit të Komisionerit Publik me nr. prot. {\*\*\*}, datë 23.09.2021, ndaj vendimit nr. 392, datë 28. 05.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), për arsyet si më poshtë.
2. Komisioneri Publik, bazuar në rekomandimin e ONM-së, datë 8.9.2021, ka ankimuar vendimin e KPK-së vetëm për kriterin e pasurisë dhe vetëm për një pasuri të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur (bashkëshortit) – *likuiditetet cash*. Shkaqet e ankimit i referohen: (a) saktësisë së deklaratimit të likuiditeteve *cash*; dhe (b) mjaftueshmërisë së burimit të ligjshëm të krijimit të likuiditeteve *cash*, në shumën 4 milionë lekë.

2.1. Në ankim, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe kontradiktor lidhur me likuiditetet *cash*, duke pamundësuar verifikimin e burimeve të ligjshme të pasurive të rrjedhura prej tyre. Komisioneri Publik, në ankim, parashtrime dhe bisedimet përfundimtare, në ndryshim nga Komisioni, pretendon se ka mospërputhje të likuiditeteve *cash* të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, për sa kohë në deklaratën *vetting* nuk janë deklaruar kursime *cash*, ndërsa sipas deklaratave periodike vjetore, gjendja e tyre në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, duhet të ishte 1.400.000 lekë. Komisioneri Publik pretendon se, lidhur me gjendjen e *cash*-it, ka deklarime kontradiktore edhe në procesverbalet e ILDKPKI-së, të mbajtura në periudhën janar – shkurt 2016.

2.2. Komisioni, për gjendjen *cash* prej 4.000.000 lekësh, është shprehur: *Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, vetting; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaramat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se pretendimi i subjektit nuk mund të merret në konsideratë në analizën financiare, për sa kohë që ky pakësim nuk është deklaruar në deklaratën periodike vjetore përkatëse, por çmon të theksojë se subjekti e ka deklaruar vullnetarisht këtë pasaktësi në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 23.02.2016, në përgjigje të pyetjes nr. 12 – nëse ka për të deklaruar pasuri, detyrime, biznes apo interesa të padeklaruara më parë në deklaramat periodike vjetore dhe se kjo ndreqje bën që gjendja e likuiditeteve *cash* në deklaratën *vetting* të jetë zero, çka përputhet me deklarimin e subjektit në këtë deklaratë.*

2.3. Sa i përket përfundimit në të cilin arriti trupi gjykues në vendim, lidhur me këtë shkak ankimi<sup>13</sup>, unë si relatore jam shprehur se qëndrojnë pasaktësitë e konstatuara në deklarimet e subjektit të

---

<sup>13</sup> Paragrafi 15.13 i vendimit të Kolegjit.



rivlerësimit dhe të bashkëshortit, për sa u përket deklaratave periodike vjetore për gjendjen e *cash-it* në banesë, në vlerën 4 milionë lekë deri në janar të vitit 2016, si dhe harresat në deklaratat vjetore të shpenzimeve prej 600.000 lekësh nga kursimet e subjektit në vitin 2013 dhe prej 800.000 lekësh nga gjendja *cash* e bashkëshortit në vitin 2014. Po ashtu, edhe deklaratimet kontradiktore në procesverbalet e datave 29.01.2016 dhe 23.2.2016, të mbajtura pranë ILDKPKI-së lidhur me ekzistencën apo pakësimin në vite të gjendjes *cash* në banesë, sjellin vështirësi në kryerjen e analizës financiare të subjektit.

2.4. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk duhej të ishte ngarkuar me përgjegjësi disiplinore në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016 dhe t’i jepej masa e shkarkimit nga detyra, për sa kohë provohet se subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim konstant sqarues dhe plotësues lidhur me shpjegimet dhe argumentet për likuiditetet *cash* prej 4 milionë lekësh: (i) në procesverbalin në ILDKPKI, më datë 23.2.2016<sup>14</sup> (deklarim me vullnetin e tij, jashtë procesit të *vetting*-ut); (ii) në pyetësorët gjatë hetimit administrativ; (iii) në parashtrimet drejtuar Kolegjit në seancën publike të datës 20 qershor 2022; (iv) në përgjigjen e pyetjeve të drejtuara nga relatorja gjatë kësaj seance; si dhe (v) në konkluzionet përfundimtare. E konsideroj bindës argumentin e subjektit të rivlerësimit lidhur me kontradiktën e krijuar mes procesverbalit të parë, të 29 janarit 2016, e thirrur pranë ILDKPKI-së (në kushtet kur bashkëshorti i subjektit nuk ishte i pranishëm, pyetjet që iu drejtuan nga institucioni kishin të bënin me deklaratimet e bashkëshortit dhe nuk i ishin vënë paraprakisht në dispozicion, duke passjellë dhënien e përgjigjeve të nxituara e të pakonsultuara), si dhe rrethanat që çuan në këtë deklaram të pasaktë<sup>15</sup>. Këto shpjegime, bazuar në nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përbëjnë provë dhe i nënshtrohen vlerësimit nga Komisioni apo Kolegji.

2.5. Në këtë kuptim, procesverbali i datës 23.2.2016, i hartuar nga inspektori i ILDKPKI-së me kërkesën dhe vullnetin e subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9049/2003, si dhe të jurisprudencës së Kolegjit<sup>16</sup>, vlerësoj se është dokument zyrtar mbi bazën e të cilit shpjegimet e subjektit kanë korrigjuar/shëruar objektivisht pasaktësitë e deklarimeve të mëparshme. Sqarimi që ka bërë subjekti i rivlerësimit në procesverbalin e dytë në ILDKPKI, në muajin shkurt 2016, është në përputhje me deklaratat e pasurisë, në të cilat bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit shpjegon shtesat dhe pakësimet e gjendjes *cash* të deklaruar prej tij.

---

<sup>14</sup> Subjekti i rivlerësimit i ripohoi këto deklaram edhe në seancën publike në Kolegj, ashtu sikurse pranë ILDKPKI-së: “Deklaroj se në momentin që ne kemi përpiluar deklaratën “vetting”, nuk kemi pasur gjendje *cash*. Deklarimi i saktë pranë ILDKPKI-së është ai i bërë më datë 23.02.2016, pasi jam konsultuar edhe me bashkëshortin. Gjendja e *cash-it* ka qenë pasuri personale e bashkëshortit, e cila është administruar prej tij, prandaj nuk kam qenë shumë e saktë në deklarimin e datës 29.01.2016. Pasi u konsultova me të, ai më shpjegoi se në fund të vitit 2014, nuk kishte deklaruar pakësimin e shumës 800.000 lekë, si dhe gjatë vitit 2015 ishte pakësuar sërish dhe më datë 23.02.2016, gjendja *cash* ka qenë 1.300.000 lekë. Mosdeklarimi i pakësimit të gjendjes *cash*, e deklaruar pranë ILDKPKI-së në datë 23.02.2016, ka qenë një pakujdesi e bashkëshortit, por pa pasur si qëllim fshehjen e pasurisë apo të burimit të saj. Në këto kushte, kjo pasaktësi nuk mund të shërbejë për marrjen e masës disiplinore”.

<sup>15</sup> Konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, datë 27.6.2022, faqe 3-4.

<sup>16</sup> Vendimi nr. 20, datë 31.7. 2019, i Kolegjit.

2.6. Në të njëjtën linjë me jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>17</sup>, si dhe duke mbajtur të njëjtin standard, çmoj se pasaktësitë e mësipërme në deklaratimet periodike të subjektit të rivlerësimit, nuk mund të konsiderohen si shkak shkarkimi në atë shkallë sa ta ngarkojnë me përgjegjësi këtë të fundit, sipas nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

3. Në ankim, Komisioneri Publik, në lidhje me mjaftueshmërinë e deklaratimit dhe burimin e ligjshëm të krijimit të likuiditeteve *cash*, në shumën 4.000.000 lekë, në ndryshim nga sa ka arsyetuar Komisioni, konstaton se: duket se janë 4 pasuri të krijuara nga kursimet *cash* të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës 2013-2016, si më poshtë:

- depozitim bankar në ABI Bank (1.500 euro – 1 prill 2015);
- blerje automjeti me targë {\*\*\*} (8.400 euro – 8 dhjetor 2015);
- depozitim në ABI Bank nga bashkëshorti i subjektit (1,3 milionë lekë – 22 shkurt 2016);
- kursime në Raiffeisen Bank nga subjekti (në shumën 1.774.148,61 lekë – deri më 31 dhjetor 2016).

3.1. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë likuiditete *cash*, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b”, në lidhje me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik, bazuar dhe në rekomandimin e ONM-së, datë 8.9.2021, vlerëson gjithashtu se referenca e Komisionit te parimi i “proporcionalitetit” për të justifikuar moszbatimin e nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, në arsyetimin e vendimit lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar, nuk gjen mbështetje në kuadrin kushtetues dhe ligjor.

3.2. Komisioni, në vendim, është shprehur se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk rezultojnë ta kenë përdorur shumën *cash* prej 4.000.000 lekësh për të investuar në pasuri të tjera, përveçse për blerjen e automjetit me targë {\*\*\*}.

3.3 Komisioni, Kolegji dhe subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet një audituesi ligjor, kanë kryer analizën financiare për mundësinë e krijimit të shumës prej 4 milionë lekësh të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, duke iu referuar të dhënave të dokumentacionit të depozituar në fashikullin e Komisionit, të cilat kishin mungesa për një periudhë kohore 2001 – 2006, si dhe në vitin 2011. Në këto kushte, ka rezultuar që analizat të nxjerrin shifra të ndryshme (Kolegji ka përdorur rezultatet e nxjerra nga Komisioni, i cili është bazuar në të dhëna të përafërta, ndërsa audituesi ligjor ka nxjerrë shifra të tjera<sup>18</sup>).

3.3.1. Vlerësoj se analizat financiare të mundësisë së krijimit të likuiditetit *cash* prej 4 milionë lekësh me të ardhura nga burime të ligjshme, të kryera si nga Komisioni, nga Kolegji, por edhe nga audituesi ligjor, duhen marrë me rezervë për shkak se janë kryer me dokumentacion të mangët,

<sup>17</sup> Vendimi nr. 37, datë 24.11.2021, i Kolegjit.

<sup>18</sup> Rezultatet e Komisionit për fitimin neto të bashkëshortit në periudhën 2001 – 2013, janë përlllogaritur në vlerën 5.655.602 lekë. Sipas raportit të audituesit ligjor A.M., rezultojnë se fitimi mesatar i realizuar për këtë periudhë, është në masën 25% ose 9.314.113 lekë dhe, bazuar në këtë fitim, analiza financiare për mundësinë e kursimit të likuiditetit *cash*, rezultojnë me balancë pozitive në shumën prej 198.014 lekë.

si dhe nuk janë futur në analizë edhe elemente të tjera, si p.sh., fakti që bashkëshorti i subjektit deri në vitin 2012, që ka filluar lidhja në martesë, ka jetuar me familjen e tij, nëna e tij ka ushtruar aktivitet biznesi, shpenzime kredie apo depozitë kursimi etj., që nëse do të ishin futur në analizë, do e ndryshonin shifrën e kursimeve të gjendjes *cash*. Nga ana tjetër, edhe marzhi i fitimit për aktivitetin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ushtruar që prej vitit 2001 për shitjen me pakicë e shumicë të artikujve industrialë, rezulton të jetë i ndryshëm<sup>19</sup>.

**3.3.2.** Shumica e trupit gjykues, për analizën e mundësisë së krijimit të pasurisë *cash* prej 4 milionë lekësh me të ardhura të siguruara nga burime të ligjshme nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka gabuar duke mos mbajtur në konsideratë: (i) mungesën e të dhënave zyrtare për disa vite për aktivitetin e bashkëshortit; (ii) pasaktësitë në llogaritjen e të ardhurave të bashkëshortit të subjektit përpara martesës; (iii) rezultatin hipotetik të të ardhurave të realizuara nga bashkëshorti.

**3.4.** Nga analiza financiare që ka bërë Kolegji mbi pretendimet e Komisionerit Publik për 4 pasuritë e pretendura të krijuara me likuiditetet *cash* prej 4 milionë lekësh, rezulton se:

**3.4.1** Për llogarinë bankare në ABI Bank, në shumën 1.505,1 euro, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari dhe ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga aktiviteti i tij tregtar, duke provuar burimin e ligjshëm të kësaj llogarie<sup>20</sup>. Analiza financiare për vitet 2015 dhe 2016, rezulton me balancë pozitive, si rrjedhojë subjekti kishte mundësi të krijonte kursimin në llogarinë e ABI Bank, si dhe të përballonte shpenzimet për këto vite<sup>21</sup>.

**3.4.2.** Për pasurinë automjet, tip “Mercedes Benz”, me targa {\*\*\*}, Kolegji shprehet<sup>22</sup> se, duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash*, pas analizës financiare për pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur deri në datën 31.12.2015, rezultoi se kanë pasur burime të ligjshme financiare për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive. Në vitin 2015, është pakësuar gjendja e *cash*-it, në shumën 1.900.000 lekë, sipas deklaramit në DIPP-në e këtij viti, nga e cila rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i tij kanë pasur mundësi të kryejnë blerjen e kësaj pasurie dhe të përballojnë shpenzimet që i përkasin këtij viti.

**3.4.3.** Për llogarinë bankare në ABI Bank, në shumën 1.300.000 lekë, depozituar në datën 22.02.2016 nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, rezultoi se nga analiza financiare e kryer në Kolegji<sup>23</sup> për krijimin e depozitës në ABI Bank, në datën 23.02.2016, pas pakësimit të kursimeve *cash* në shumën 1.051.354 lekë, e mbetur nga viti 2015, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i

---

<sup>19</sup> Marzhi i fitimit i përdorur nga Komisioni për vitet 2001 – 2007, ka qenë 25,54%, por audituesi ligjor, në analizën e tij, shprehet në vitet e para të ushtrimit të aktivitetit, marzhi i fitimit të ushtrimit të aktivitetit dhe norma e interesit bankar kanë qenë dukshëm më të lartë.

<sup>20</sup> Paragrafi 17.5 i vendimit të Kolegjit.

<sup>21</sup> Paragrafi 17.5.4 i vendimit të Kolegjit.

<sup>22</sup> Paragrafët 16.2 – 16.2.4 të vendimit të Kolegjit.

<sup>23</sup> Paragrafi 17.3 i vendimit të Kolegjit.

saj nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar krijimin e kësaj depozite dhe përballimin e shpenzimeve të tjera për diferencën negative prej 223.945 lekësh.

**3.4.4.** Për llogarinë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit, në Raiffeisen Bank, me balancë në shumën 1.774.148,61 lekë në datën 31.12.2016, e cila rezulton të jetë një llogari page, nga analiza financiare rezultoi se teprica kreditore ka filluar në vitin 2012. Komisioneri Publik është shprehur se kursimet në këtë llogari bankare që janë krijuar gjatë periudhës 2012-2016 dhe kanë si burim të ardhurat nga paga, nuk do të mund të krijoheshin, nëse nuk do të mbuloheshin shpenzimet e tjera të familjes nga pakësimi i likuiditeteve *cash*, siç është deklaruar përkatësisht në DIPP-në e vitit 2015.

**3.5.** Për pasurinë automjet, tip “Mercedes Benz”, me targa {\*\*\*}, nga analiza financiare në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur mundësi të krijojnë pasurinë automjet dhe të përballonin shpenzimet e tyre për periudhën 01.01.2014 - 14.04.2014, për vlerën 1.332.391 lekë<sup>24</sup>. Analiza ekonomike totale e vitit 2014, rezulton me një diferencë negative në shumën 377.355 lekë.

**3.6.** Referuar konkluzioneve të nxjerra në vendim nga shumica e trupit gjykues, çmoj se mungesa e burimeve financiare të ligjshme, nuk ka rezultuar për të gjitha pasuritë e pretenduara nga Komisioneri Publik të krijuara nga likuiditeti *cash* në shumën prej 4 milionë lekësh, por vetëm për dy prej tyre: për llogarinë bankare në ABI Bank, në shumën 1.300.000 lekë dhe për pasurinë automjet, tip “Mercedes Benz”, me targa {\*\*\*}. Shumica e trupit gjykues ka mbajtur në konsideratë pretendimin e shprehur në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, të ligjshmërisë së të ardhurave të bashkëshortit në shumën prej 2.351.358 lekësh<sup>25</sup>, si dhe ka pranuar në total se për krijimin e këtyre pasurive, subjekti i rivlerësimit rezulton me diferencë negative në shumën 1.556.336 lekë, duke mos konsideruar zbatimin e parimit të proporcionalitetit.

**3.7.** Në analizën e rrethanave faktike dhe vlerësimin tërësor të çështjes, vlerësoj se pamundësia financiare e rezultuar për subjektin e rivlerësimit nuk duhej të përbënte shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sepse:

**3.7.1.** likuiditetet *cash*, në shumën 4.000.000 lekë, janë deklaruar për herë të parë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. P., në deklarinë periodik të pasurisë për vitin 2013, në cilësinë e personit të lidhur, si të ardhura nga aktiviteti i tij i biznesit, zhvilluar për një periudhë të gjatë kohore përpara se të lidhte martesë me subjektin e rivlerësimit (në vitin 2012);

**3.7.2.** ankimi i Komisionerit Publik është bërë vetëm për 1 pasuri të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur (bashkëshortit), në ndryshim nga Komisioni ku është analizuar e gjithë pasuria;

---

<sup>24</sup> Paragrafi 18.13 i vendimit të Kolegjit.

<sup>25</sup> Subjekti i rivlerësimit ka zbritur nga shuma *cash* prej 4.000.000 lekësh, diferencën negative të konstatuar nga Komisioni, në shumën prej 1.648.666 lekësh. Shuma prej 2.351.358 lekësh është analizuar edhe në Kolegj.

3.7.3. është rënduar pozita e subjektit të rivlerësimit duke i trajtuar pasuritë e krijuara nga likuiditetet *cash* prej 4 milionë lekësh, si pasuri të shkëputura e të veçuara dhe duke ia nënshtruar analizës financiare si në momentin e krijimit të tyre, ashtu edhe të analizës vjetore.

3.8. Për sa analizuar më lart, konstatoj se shumica e trupit gjykues, në çështjen e subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), ka shkelur standardet objektive të vendosura në jurisprudencën e Kolegjit<sup>26</sup> e që duhet të zbatohen rast pas rasti, pasi: (i) masa disiplinore e shkarkimit nuk është në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit; (ii) gjykimi nuk është bërë në tërësinë e procesit të rivlerësimit dhe shkelja e kryer nuk e pengon zbatimin e këtij parimi; (iii) dhënia e masës disiplinore nuk është bazuar në standarde objektive dhe nuk është në proporcion me shkeljet e konstatuara, duke tejkaluar qëllimin e ligjit nr. 84/2016.

3.9. Vlerësoj se shumica e trupit gjykues duhet të kishte aplikuar zbatimin e parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, mbështetur në jurisprudencën e krijuar të Kolegjit<sup>27</sup>, duke mbajtur në konsideratë se subjekti i rivlerësimit kishte arritur nivel të besueshëm dhe ishte kualifikuar edhe në dy kriteret e tjera, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale. Vlerësoj se rëndesa e shkeljeve të konstatuara nuk mund të çojë në aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

3.10. Në përfundim të arsyetimit të mësipërm, konkludoj se vendimi i Komisionit nr. 392, datë 28.05.2021, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe, për këtë arsye, duhej të lihej në fuqi.

**GJYQTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

---

<sup>26</sup> Vendimi i Kolegjit nr. 17/2022.

<sup>27</sup> Vendimet e Kolegjit nr. 14/2020; nr. 18/2021; nr. 26/2021; nr. 17/2022; nr. 19/2022.